

ABSTRAKT

Ky punim ka për qëllim studimin lidhur me dhunën në familje kundër gjinisë mashkullore. Ky studim shtrihet deri në atë pikë sa kërkohen edhe shkaqet apo arsytet se pse burrat hezitojnë të raportojnë dhunën në familje. Punimi është fokusuar te personat e gjinisë mashkullore si viktimat të dhunës në familje, me gratë dhe po në të njëjtën kohë pjesëtarët tjerë të familjes si autorë të kësaj dhune kundër gjinisë mashkullore.

Gjithashtu, ky punim identifikon boshllëqet në ofrimin e shërbimeve nga ana e institucioneve kompetente të cilat janë të thirrura për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, kjo pasi që viktimat meshkuj gjithashtu hasin në vështirësi në gjetjen e shërbimeve specifike për nevojat e tyre sepse linjat e ndihmës ose strehimoret synohen ekskluzivisht për viktimat femra.

Gjetjet e këtij punimi sugjerojnë se shoqëria duhet të jetë e vetëdijshme se edhe personat e gjinisë mashkullore janë viktimat të dhunës në familje dhe se të njëjtit ndjejnë nevojën për tu mbështetur dhe për tu krijuar kushte të njëjta jo diskriminuese nga shoqëria dhe institucionet kompetente.

Sipas të dhënave të organeve kompetente dhe statistikave të ndryshme të cilat paraqiten në mënyrë periodike, rezultojnë se numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje e veçanërisht nga viti në vit këto ngritje janë shënuar tek rastet e dhunës ndaj viktimave meshkuj. Kjo ndoshta edhe nga shkak i sensibilizimit dhe vetëdijesimit qytetar për të raportuar dhunën në familje, duke mos përfshirë këtu rastet që mbeten përsëri të pa raportuara.

Ushtrimi i dhunës ndaj pjesëtarëve të familjes të gjinisë mashkullore, pas pasojave individuale që i shkaktohen viktimës, reflektohen edhe pasoja tjera negative edhe në raportet tjera familjare. Pas zbehjes së harmonisë mes çifteve, raporteve tjera familjare, në rastet e caktuara dhuna e vazhdueshme krijon paqëndrueshmëri të jetës së mëtejme të përbashkët, që përfundon edhe me ndarje, përkatësisht shkurorëzime, shpërbërje të familjes e pasoja të tjera ku preken edhe pjesëtarët më të ndjeshëm e që janë fëmijët.

Në këtë punim do të paraqitet edhe një anketë e cila do të paraqes gjetje në detaje lidhur me faktorët të cilët ndikojnë në (mos) raportimin e dhunës në familje nga viktimat meshkuj.

Fjalë kyçe: Dhuna ndaj burrave; (Mos) raportimi dhunës; Urdhri mbrojtës; Pasojat e dhunës.